



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.878/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada - Gllgjani, Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtimes, Shkurte Mustafa nga Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Shtimës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.878/2021 i datës 04.11.2021, i ushtruar nga Shkurte Mustafa nga Komuna e Shtimes, Kandidate për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 2948-2021 të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 2206E/03R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidaten për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Komuna Shtime, në Vendvotimin: 2206E/03R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.878/2021, të ushtruar nga Shkurte Mustafa nga Shtimja, Kandidate për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilin pretendon se në vendvotimin me numër 2206E/03R, ka mos përputhje të rezultateve në mes të FLK-së dhe FRK-së, nga ky lëshim thekson se është dëmtuar për 60 vota, më tutje pretendon se kryesuesi dhe anëtarët e KVV-së e kanë pranuar këtë gabim teknik, dhe si dëshmi ka bashkangjitur edhe deklaratën e kryesuesit dhe anëtareve të KVV-së, me të cilën deklarojnë se gjate mbledhjes së rezultateve për kandidaten e Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosje Shkurte Mustafa, ka ndodhur një gabim ku në Formulari i Llogaritjes së Kandidatëve (FLK) ka pasur 68 vota gjate bartjes se votave në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) ka shkruar vetëm 8 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidatja për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, Shkurte Mustafa, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 2206E/03R. PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga Shkurte Mustafa, me të cilin apel kërkon që ti rinumërohen votat në vendvotimin e lartcekur ku ka mos përputhje të rezultatit mes FLK-së dhe FRK.

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidatja, ku shihet qarte se në qendrën e votimit 2206E/03R, ku shihet qartë se ka mos përputhje të votave mes FLK-së dhe FRK-së, në FLK figurojnë 68 vota për kandidaten në fjalë ndërsa në FRK figurojnë vetëm 8 vota, andaj ky panel, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura, si në pikën II të dispozitivit.

Me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 878/2021 më datën 05.11.2021.

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.